



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË  
Fakulteti i Edukimit

Nr. prot 472/11 Dt. 09.11.2021

KËSHILLI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT, në mbështetje të në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit më datë 09.11.2021 merr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET raporti i komisionit të ankesave nr. 440 dt. 08.11.2021 për refuzimin e ankeses së paraqitur nga kandidatja, Hydajete Sadiku- Ibrahim, ndaj raportit të komisionit recenzues nr.392, dt 26.10.2021, i publikuar në Buletinin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Arsyetim

Komisioni i ankesave ka konstatuar se kandidatja Hydajete Sadiku- Ibrahim nuk e plotëson pikën 1.1 të nenit 171 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe pikën 3.1 të nenit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, ku thuhet se kandidati duhet të ketë përfunduar studimet master ose ekuivalent me lëminë përkatëse. Ndërsa kandidatja e përzgjedhur Gentiana Imeraj, ka drejtimin master në Fakultetin e Edukimit, "Master i mësimdhënies në matematikë".

Po ashtu kandidatja e përzgjedhur plotëson edhe pikat tjera 3.2 dhe 3.3 të nenit 7 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, nr. 1670, dt.28.09.2021, kandidatja e përzgjedhur Gentiana Imeraj ka notë mesatare më të lartë se parashtruesja e ankesës Hydajete Sadiku- Ibrahim, dhe po ashtu ka moshën nën 30 vjeç.

Andaj në bazë të cekurave më lartë komisioni i ankesave i ka propozuar Këshillit të Fakultetit të Edukimit refuzimin e ankesës së kandidates Hydajete Sadiku- Ibrahim.

**I dorëzohet:**

Zyrës për çështje akademike  
Sekretarit të FEdu  
Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit  
Prof. Ass. Dr. Besim Gollopeni





UNIVERSITETI I MITROVICËS  
"ISA BOLETINI"  
FAKULTETI I EDUKIMIT

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535625

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË  
FAKULTETI I EDUKIMIT

Njesia organ.	Numer	Nr. Ekzempl.	Vlera
Nr. Prot.	440	Dt	

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit të datës 20.10.2021 me Nr. Prot. 37015 të datës 20.10.2021 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njëjësive akademike në Universitetin "Isa Boletini", për vitin akademik 2021-22 të datës 01.10.2021 me Nr. Prot. 1712. Komisioni është mbledhur me datën 08.11.2021 për të shqyrtuar ankesën e Hydajete Sadiku – Ibrahimimi e paraqitur me Nr. Prot. 424 me datën 03.11.2021, komisioni i lartëcekur mori këtë:

## R A P O R T

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 424 të datës 03.11.2021 nga kandidatja Hydajete Sadiku – Ibrahimimi.
- II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Me konkursin e datës 01.10.2021 me Nr. Prot. 1712 Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë ka shpallur Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për vitin akademik 2021-22.

Komisioni vlerësues me datë 26.10.2021 ka përpiluar raportin vlerësues për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime për vitin akademik 2021-22, për pozitën një asistent për lëndët: Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme, Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme, Matematika elementare I, Matematika elementare II, Metodologji e mësimin të matematikës I, Metodologji e mësimin të matematikës II, Lojërat matematikore, ankesë ka paraqitur kandidatja Hydajete Sadiku – Ibrahimimi.

Sa i përket ankesës së kandidatës në fjalë se kandidatja e përzgjedhur i ka të përfunduar studimet themelore në Matematikë Financiare 3 vjeçar, ku thekson se nuk është adekuate për mësimdhënie, dhe pretendon se studimet e saja të drejtimit Matematikë e përgjithshme 4 vjeçar janë adekuate për ciklin universitar.

Komisioni i ankesave ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve Hydajete Sadiku – Ibrahimimi dhe Gentiana Imeraj të paraqitur për pozitën një asistent për lëndët: Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme, Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme, Matematika elementare I, Matematika

elementare II, Metodologji e mësimit të matematikës I, Metodologji e mësimit të matematikës II, Lojërat matematikore, dhe ka ardhur në përfundim:

Kandidatja Hydajete Sadiku – Ibrahimimi nuk e plotëson pikën 1.1 të nenit 171 të Statutit të Universiteti “Isa Boletini”, dhe pikën 3.1. të nenit 7 të Rregullorës për procedurat vlerësuese lidhur me angazhmin e bashkëpunorëve të jashtëm në UIBM, ku thuhet se kandidati duhet “Të ketë të përfunduar studimet Master ose ekuivalent me të në lëminë përkatëse”, ndërsa kandidatja e për zgjedhur ka drejtimin master në Fakultetin e Edukimit UP “Master i mësimdhënies në matematikë” që është në përputhje me nenin 3.1. të nenit 7 të Rregullorës për procedurat vlerësuese lidhur me angazhmin e bashkëpunorëve të jashtëm në UIBM. Ashtu siç është cekur në raportin e Komisionit vlerësues, si rrjedhim Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit të Edukimit të refuzohet kjo pikë e ankesës.

Gjithashtu Komisioni i ankesave konstaton se kandidatja e për zgjedhur plotëson edhe pikat tjera si: 3.2 dhe 3.3 të nenit të 7 të rregullorës për angazhmin e bashkëpunorëve të jashtëm në UIBM, që kandidatja e për zgjedhur ka notat mesatare më të larta se kandidatja tjetër dhe po ashtu moshën nën 30 vjet.

Gjithashtu Komisioni i ankesave konstaton se kandidatja e për zgjedhur i plotëson të gjitha kushtet e parapara me Statutin e UIBM dhe po ashtu Rregullorës për angazhmin e bashkëpunorëve të jashtëm në UIBM.

Konstatim i përgjithshëm i Komisionit të ankesave është se refuzohet ankesa e kandidatës Hydajete Ibrahimimi – Sadiku, si e pa bazuar dhe po ashtu i propozon Këshillit të Fakultetit që kjo ankesë të refuzohet.

Komisioni:

Prof. Ass. Dr. Eliza Avdiu, Kryetare

Ass. Leonora Çarkaj, Anëtare

Ass. Ylli Hashani, Anëtar

Raporti iu dërgohet:

*Arkivës së Fakultetit*

*Këshillit të Fakultetit*

*Parashtrueses së ankesës*